



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT KRYETARI

Adresa: Kontrolli i Lartë i Shtetit Rruga "Abdi Toptani" Nr.1 Tiranë. E-mail: klsh.org.al; web-site www.klsh.org.al

Nr. 484/6 Prot.

Tiranë, më 30/07/2018

V E N D I M

Nr. 92, Datë 30/07/2018

PËR

AUDITIMI I USHTRUAR NË BASHKINË KORÇË DHE 6 ISH- KOMUNAT DRENOVË, VITHKUQ, VOSKOP, LEKAS, MOLLAJ DHE BULGAREC ME OBJEKT "AUDITIM FINANCIAR PËR PERIUDHËN 01.01.2017 – 31.12.2017 DHE PËRPUTHSHMËRIE PËR BASHKINË KORÇË PERIUDHA 01.01.2016 – 31.12.2017 DHE 6 ISH- KOMUNAT DRENOVË, VITHKUQ, VOSKOP, LEKAS, MOLLAJ DHE BULGAREC PERIUDHA 01.01.2013 – 31.07.2015

Nga auditimi i ushtruar në Bashkinë Korçë dhe 6 ish- komunat Drenovë, Vithkuq, Voskop, Lekas, Mollaj dhe Bulgarec, rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të cilat në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, të përhapura, në llogaritë vjetore, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinionit të kualifikuar (me rezervë). Fusha kryesore të cilat janë konstatuar gabime është ajo e zhvillimit të procedurave të prokurimit dhe zbatimit të kontratave të punimeve.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", me qëllim përmirësimin e gjendjes.

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar në Bashkinë Korçë për periudhën 01.01.2016 – 31.12.2017 (auditim financiar) dhe 6 ish- komunat Drenovë, Vithkuq, Voskop, Lekas, Mollaj dhe Bulgarec për periudhën 01.01.2013 – 31.07.2015 (auditim përputhshmërie prokurimet), sipas programit nr. 484/1, datë 03.05.2018 dhe shtesës nr. 484/2, datë 01.06.2018.

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

A. OPINIONI I AUDITUESIT:

Opinioni i kualifikuar (me rezervë)

“Sipas mendimit tonë, pasi kemi marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, mbështetur në standartet ISSAI 1700¹ dhe ISSAI 1200² shprehim një opinion të kualifikuar për llogaritë vjetore të Bashkisë Korçë, duke arritur në përfundimin se anomali të apo rastet e mospërrputshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, të përhapura, në llogaritë vjetore”.

a- Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Bashkisë Korçë, e cila përbëhet nga pasqyrat financiare (bilanci) të institucionit më 31 Dhjetor 2017, pasqyra e performancë financiare, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e fluksit të parasë, burimet dhe shpenzimet lidhur me investimet, pasqyra mbi gjendjen dhe ndryshimet në aktivet e qëndrueshme si dhe amortizimin e tyre, pasqyra e lëvizjes së fondeve dhe shënimet shpjeguese.

Në rrethanat e mësipërme, duke marrë në konsideratë faktin se subjekti i audituar mund të mos arrijë në kuptimin e saktë të opinionit mbi pasqyrat financiare, duam të tërheqim vëmendjen për rezervat në opinion (ISSAI 1705)³ të faktit se, jemi të pasigurt për disa çështje të pazakonta të konstatuara, të cilat janë *materiale*, dukshëm mbi nivelin e materialitetit, me ndikim në vendimmarrjen e përdoruesit të pasqyrave financiare si:

Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës ka marrë në konsideratë pragun e materialitetit prej 2% për tu konsideruar, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të ulët deri në të moderuar.

Duam të tërheqim vëmendjen tuaj për rezervat në opinion të faktit se jemi të pasigurt për disa çështje specifike që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare të cilat janë materiale por jo thelbësore për arsyetimin e pasqyrave si:

-Mbajtja e kontabilitetit në mënyrë manuale duke mos aplikuar ndonjë program financiarë.

-Xhirot debitore e kreditore të llogarive sintetike nuk janë përmbledhur në bilancin vërtetues, duke vështirësuar rregullimin e gabimeve të mundshme gjatë vitit.

-Pozicioni financiarë i letrave me vlerë është pasqyruar më pak se të dhënat e kontabilitetit të arkës për vlerën 2,883,976 lekë, pasi veprimet kontabël janë kryer me çmimin e shitjes të letrave me vlerë dhe në bilanc janë paraqitur me çmimin e kostos (të blerjes).

-Në ditarin e veprimeve të ndryshme janë azhurnuar artikuj kontabël të dubluar pasi janë përfshirë edhe në ditarët përkatës të bankës dhe të arkës. Gjithashtu janë azhurnuar veprime pa përshkrim e veprimit, pa datë dhe ekstreme dokumentacioni dhe gjurmë të rregullimit të gabimeve.

-Në ditarin e veprimeve të ndryshme janë azhurnuar artikuj kontabël të dubluar pasi janë përfshirë edhe në ditarët përkatës të bankës dhe të arkës. Artikujt kontabël të regjistruar në ditarin e veprimeve të ndryshme janë pa përshkrim veprimi, pa datë dhe ekstreme dokumentacioni dhe gjurmë të rregullimit të gabimeve e sistemeve përkatëse.

-Në ditarin e kontabilizimeve të hyrjeve e daljeve të magazinës nuk ka përshkrim veprimesh dhe nuk është vepruar me llogarinë nr. 45 “Marrëdhënie brenda e jashtë sistemit” në rastet e qarkullimit të vlerave materiale në njësitë vartëse për vlerën 119,589 lekë, veprim i cili është

¹ Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe llogarive bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit dhe të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.

² Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përse i takon gjetjeve nga auditimi.

³ Kur gabimet janë materiale por jo të përhapura, audituesi paraqet një opinion të kualifikuar.

kryer në ditarin e veprimeve të ndryshme (Ekstra kontabël). Gjithashtu janë kryer sistemim veprimi (në ditarin e veprimeve të ndryshme), duke pakësuar llogarinë nr. 32 "Objekte inventari", për nxjerrje jashtë përdorimit për vlerën 3,255,349 lekë, ku duhej të ishte prerë fletë dalje përveç proces verbalit të komisionit.

Në magazinën e Bashkisë Korçë janë bërë hyrje në pajisje (Windows server licencë 1(një) me vlerë 648,000 lekë dhe Hardware Servera 1(një) me vlerë 1,944,000 lekë, gjithsej 2,592,000 lekë, të cilat janë bërë dalje Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit Tiranë me fletë dalje nr. 252, datë 18.05.2017, nga kjo e fundit nuk është prerë fletë hyrje dhe mungon konfirmimi(janë marrë në ruajtje pa fletë hyrje).

Nga verifikimi i inventarin fizik , për licencën në vlerën 648,000 lekë dhe Hardware Servera 1 (një) me vlerë 1,944,000 lekë nuk janë të përfshira në pasqyrën e bilancit nr. 6 "Ndryshimi i aktiveve të qëndrueshme" dhe nuk janë përfshirë në inventarë fizik të Bashkisë .

Për lëvizjen e inventari në drejtim të AKISH, nuk është vepruar me llogarinë nr. 45 "Marrëdhënie me njësitë brenda e jashtë sitemit". Mungesa e konfirmimit nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit Tiranë duhej të pasqyrohej në bilanc në debit të llogarisë nr. 45, me vlerën 2,592,000 lekë, por në fakt nuk është pasqyruar në aktiv të bilancit.

-Janë bërë hyrje "Tabela informuese për stacionet e autobuzave" me vlerë 2,700,000 lekë dhe "Tabelë informuese për stacionet interurbane" në vlerë 250,000 lekë, sipas proces verbalit të datës 30.08.2017. Edhe pse Bashkia Korçë i ka marrë falas nga Bashkia e Elbasanit, konstatohet se nuk është zbatuar afati i kontratës 12 mujor (sipas nenit 20 pika "b"), dhe nuk janë llogaritur penalitetet për tejkalim të afatit kontratës në vlerën 1,484,500 lekë.

-Janë mbartur në bilancin e vitit 2017, në llogarinë nr. 202 "Studime e Kërkime", nga ish-komunat 153 projekte me vlerë lekë 32,612,002 lekë, në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 08.05.2003 "Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit" pika C "Të ndryshme", pasi vlera e projekteve i kalon objektit të përfunduar.

-Janë transferuar gjatë vitit 2016, në njësitë vartëse 45 projekte në vlerë 8,075,579 lekë, në Ndërmarrjen e Ujësjellës Kanalizimeve Korçë 15 projekte me vlerë 3,340,480 lekë, në Ndërmarrjen e shërbimeve Publike 18 projekte me vlerë 2,035,199 lekë dhe në Ndërmarrjen Shërbimit të Arsimit 12 projekte me vlerë 2,699,900 lekë. Transferimet në njësitë vartëse nuk janë kryer me fletë dalje, por me lista duke mos vepruar në kontabilitetet nëpërmes konfirmimeve (llogaria nr. 45). Nga verifikimi pasqyrës nr. 6" Ndryshimi i aktiveve të qëndrueshme " në bilancet e tre njësive me pasqyrën e bilancit të bashkisë nuk rakordon për 348,000 lekë, diferencë që i përket Ndërmarrjes së Shërbimeve publike.

Përfundimisht në bilancin e vitit 2017, llogaria nr. 202 "Projekte e studime" paraqitet me pozicion financiarë me vlerë 139,250,428 lekë, por nga bashkia nuk ka inventarë të saktë të projekteve që janë vënë në zbatim nga ish-komunat për të rritur vlerën e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara.

Gjithashtu nga Bashkia nuk janë saktësuar projektet e zbatuara për të cilat duhet të rritet vlera e objekteve të marra në dorëzim dhe të pakësohet teprica e llogarisë për vlerën 139,250,427 lekë në bilancin e bashkisë dhe vlerën 8,075,579 lekë në bilancet e njësive vartëse.

-Mos kundrimi i debitorëve në fund të vitit 2017, midis Drejtorisë së të Ardhurave dhe Drejtorisë së Financës për vlerën 51,490,018 lekë, si rezultat i mos kontabilizimit nga Drejtoria e. Financës të debitorëve të vitit 2017 në shumën 47,033,021 lekë dhe penalitetit për mos pagesë në afat të detyrimeve në vlerën 4,458,997 lekë.

-Ekzistenca e një numri të lartë të detyrimeve debitorë për 1872 subjekte me vlerë 188,143,405 lekë, me gjithë masat e marra nga Drejtoria e të Ardhurave për arkëtimin e tyre.

-Mos menaxhim i mirë i taksës së parkimit në rrugë nga agjenti "A.....Y", e cila ka ndikuar në mos arkëtimin e të ardhurave të parashikuara sipas studimit të fizibilitetit.

-Mos menaxhim i mirë e pronave të Bashkisë Korçë, duke mos evidentuar sipërfaqet pyjore/kollusore të marra në shfrytëzim nga subjektet minerale dhe me licencë nga MIE për zvogëlimin e këtyre sipërfaqeve, si dhe mos ndjekja e arkëtimit dhe llogaritjes së saktë të

detyrimeve kontraktuale për qiranë e objekteve, pyjeve/ kullotave dhe tokës bujqësore me të ardhur me mungesë në vlerën 6,312,866 lekë.

b- Nga auditimi mbi përputhshmërinë, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë nga subjekti Bashkia Korçë dhe 6 ish- komunat Drenovë, Vithkuq, Voskop, Lekas, Mollaj dhe Bulgarec, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve **në procedurat e prokurimit**, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), bazuar në ISSAI 4000 “Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë”, “Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë”, u evidentuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të cilat konsistojnë:

- Shkelje të kuadrit rregullator në fuqi në fushën e zhvillimit të procedurave të prokurimit publik, lidhur me kualifikimin dhe shpalljen fitues të operatorëve ekonomik. Për arsye të kualifikimit dhe shpalljes fitues të operatorëve ekonomikë në kundërshtim me kërkesat ligjore, pasi janë kualifikuar pa plotësuar plotësisht kriteret e DST.

- Në realizimin e kontratave të punimeve, u konstatuan likuidime të disa proceseve të punës pa u kryer punimet në vlerën 25.7 milionë lekë.

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI 1700⁴ dhe standarde ISSAI 1200⁵). Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

B. MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga auditimi: Në pasqyrën financiare nr. 6 “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara” në llogarinë nr. 202 “Studime e kërkime” është mbartur nga viti 2016 vlera 88,052,835 lekë. Pozicioni financiarë përbëhet nga projekte që ju përkasin objekteve në fushën e ndërtimeve. Në regjistrimet kontabël në këtë llogari janë mbartur 153 projekte ndërtimore të ish-Komunave në vlerën 32,612,002 lekë. Në bilancet e ish- komunave të 6/mujorit parë të vitit 2015, vlera e projekteve duhej të ishte kaluar me veprim kontabël në vlerën e objekteve përkatëse, në rastet e objekteve të përfunduara e të marra në dorëzim.

Edhe nga Bashkia Korçë është ndjekur e njëjta praktikë duke i mbartur vlerën e projekteve edhe pas marrjes në dorëzim të objekteve. Në bilancin e vitit 2017, llogaria nr. 202 “Studime e kërkime”, ka pozicion aktiv financiar në vlerën 139,250,428 lekë. Kjo praktikë e ndjekur nga bashkia nuk është në përputhje me UKM nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit” pika C “Të ndryshme”, pasi vlera e projekteve i kalon objektit të përfunduar (Trajtuar në pikën III/A (3.2), faqet 17-30 të Raporti Përfundimtar të Auditimit).

NIVELI I PRIORITETIT

I mesëm.

1.1 Rekomandimi: Drejtorja e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikim Zhvillim Territorin të kryej rakordimet për saktësimin e projekteve që janë zbatuar dhe i kanë kaluar njësive vartëse si dhe të atyre që administrohen në bashki, mbështetur në të dhënat e bilancit kontabël të vitit 2017, për vlerën e projekteve prej 139,250,428 lekë. Pas saktësimit të projekteve

⁴Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe llogarive bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit dhe të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionin.

⁵Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përsa i takon gjetjeve nga auditimi.

ndërtimore që janë vënë në zbatim, të kryhet veprimi kontabël duke kredituar llogarinë nr. 202 “Studime e kërkime” dhe debituar llogaritë përkatëse (aktiveve të qëndrueshme afatgjata). E njëjta procedurë të ndiqet edhe për projektet transferuara në njësitë vartëse.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2018

2. Gjetje nga auditimi: Me fletë hyrjen nr. 2, datë 25.01.2017 janë bërë hyrje pajisje (Windows server licencë 1(një) me vlerë 648,000 lekë dhe Hardware Server 1(një) me vlerë 1,944,000 lekë, gjithsej 2,592,000 lekë. Këto pajisje janë bërë dalje sipas fletë daljes nr. 252, datë 18.05.2017 dhe marrëveshjes nr. 2274, datë 17.05.2017. Grupi i Auditimit pasi verifikoi inventarin fizik konstatoi se licenca në vlerën 648,000 lekë nuk është përfshirë në inventarë dhe në pasqyrën e bilancit nr. 6 “Ndryshimi i aktiveve të qëndrueshme” (Vlera bruto). Gjithashtu dhe “Serveri” duhet të pasqyrohet në inventarin e Bashkisë, pasi nuk është lëshuar fletë hyrje në ruajtje nga AKSHI (me pretendimin se nuk i lejohet), veprime të cilat kanë bërë që pasqyra nr. 6, “Ndryshimi i aktiveve të qëndrueshmet trupëzuar” me inventarin fizik të mos kuadrojë (Trajtuar në pikën III/A (3.2), faqet 17-30 të Raporti Përfundimtar të Auditimit).

NIVELI I PRIORITETIT

I mesëm

2.1. Rekomandimi: Bashkia Korçë të marrë masa, për përfshirjen në inventarë fizik në llogarinë nr. 2314 “Instalime teknike makinerie pajisje, instrumente dhe vegla pune”, të serverit me vlerë 1,944,000 lekë dhe Windows server licencë 1(një) me vlerë 648,000 lekë, pasi nuk janë pasqyruar inventarin fizik të vitit 2017.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2018

3. Gjetje nga auditimi: Në plotësimin e pasqyrave financiare (bilancit kontabël) të vitit 2017, u konstatuan se janë kryer veprime të dubluara në ditarin e veprimeve të ndryshme dhe janë hedhur në centralizator (libri përmbledhës i llogarive). Disa pozicione llogarish nuk janë sipas ditarëve të kontabilitetit. Kështu pozicioni financiarë i letrave me vlerë është pasqyruar më pak se të dhënat e kontabilitetit të arkës për vlerën 2,883,976 lekë. Ndryshimi i gjendjeve të inventarit nuk është pasqyruar sipas të dhënave të kontabilitetit. Në bilanc ndryshimi i gjendjeve të inventarit është paraqitur në vlerë – 1,987,646 lekë në pasqyrën nr. 1, rreshti nr. 28, ndërsa në pasqyrën nr. 3/2 “Të ardhura të ushtrimit”, në rreshtin nr. 83, llogaria 841 është paraqitur me vlerë 2,247,904 lekë, ose është paraqitur më shumë në vlerë 260,257 lekë, si rezultat i parregullsive në kontabilizim (Trajtuar në pikën III/A (3.2), faqet 17-30 të Raporti Përfundimtar të Auditimit).

NIVELI I PRIORITETIT

I ulët

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa për sistemimin e veprimeve në kontabilitet të gjendjes së arkës së letrave me vlerë për shumën 2,883,976 lekë, referuar kontabilizimeve në ditarin e arkës, si dhe të sistemohet ndryshimi i gjendjeve të inventarit për vlerën 260,257 lekë, për sa është paraqitur më shumë se diferenca e gjendjes në fillim dhe në fund të vitit 2017.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2018

4. Gjetje nga auditimi: Nga grupi i inventarizimit është konstatuar se inventarët e makinave jo në gjendje pune (6 automjete), mbahen në kontabilitete në llogarinë nr. 215 “Mjete transporti”, që në fakt duhej të mbaheshin në kontabilitet në llogarinë nr. 24 “Aktive të dëmtuara” në formatin nr. 1, të bilancit të vitit 2017, për vlerën 5,031,079 lekë dhe njëkohësisht duhet të grumbullohen dhe jo të ruhen në njësitë administrative (Trajtuar në pikën III/A (3.2), faqet 17-30 të Raporti Përfundimtar të Auditimit).

NIVELI I PRIORITETIT

I ulët

4.1. Rekomandimi: Bashkia Korçë të marrë masa për grumbullimin e mjeteve të dëmtuara (jo në gjendje pune) dhe nga Drejtoria e Financës të sistemohen në kontabilitet në llogarinë përkatëse (llogaria nr. 24 “Aktive të dëmtuara”), deri në momentin e rivlerësimit me komision të posaçëm për nxjerrje jashtë përdorimit.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2018

5. Gjetje nga auditimi: Kontabiliteti mbahet me program të thjeshtë në pasqyra të Word dhe Excel dhe nuk është aplikuar ndonjë program informatik, duke u bërë premisë për gabime të mundshme në përmbledhjen e veprimeve dhe nxjerrjen e bilancit dhe plotësimin e pasqyrave financiare (*Trajtuar në pikën III/A (3.2), faqet 17-30 të Raporti Përfundimtar të Auditimit*).

NIVELI I PRIORITETIT

I ulët

5.1. Rekomandimi: Bashkia Korçë të marrë masa për përfshirjen në program informatik mbajtjen e kontabilitetit për të shmangur gabimet e mundshme në mbajtjen e kontabilitetit dhe plotësimin e pasqyrave financiare.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Korçë nuk janë implementuar si duhet kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, për arsye se nuk ka hartuar politika, objektiva, plane strategjike e vjetore, plan-veprime të miratuara për arritjen e qëllimeve strategjike, që përmbajnë veprime, afate, dhe persona konkret përgjegjës për çdo veprim të parashikuar, nuk është hartuar rregullorja e re, nuk janë miratuar rregulla për garantimin e ruajtjes së informacionit, në kundërshtim me nenin 8, pika (ç) dhe nenit 22, pika (g)”, të ligjit të MFK si edhe nuk janë futur procedura antikorupsion.

Nuk është formuluar deklarata e vizionit dhe misionit të njësisë në të cilën të jenë përcaktuar objektivat strategjike afatgjatë për Bashkinë Korçë sipas VKM nr. 691, datë 29.7.2015 “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore 2015 - 2020”. (*Trajtuar në pikën III/A (3.1), faqet 14-17 të Raporti Përfundimtar të Auditimit*).

NIVELI I PRIORITETIT

I mesëm.

6.1. Rekomandimi: Bashkia Korçë të marrë masa për implementimin e një sistemi të përshtatshëm rregullash të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke hartuar rregullore dhe procedura të qarta për të gjithë aktivitetin e përditshëm të institucionit.

Të hartohet rregullorja e brendshme e institucionit në përshtatje të organizimit të kësaj njësie vendore si rezultat i reformës territoriale, si dhe të hartohen plane konkrete, strategjike e vjetore për zhvillimin e njësisë vendore.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Njësia e auditit të brendshëm publik të Bashkisë Korçë, nuk ka dhënë mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave, pasi në auditimet e planifikuara dhe të realizuara nuk është bazuar në vlerësimin e riskut për auditimin e fushave me risk, si prokurimet publike, kontratat e dhënies me qira, administrimi i aseteve, etj.

Njësia e Auditit të Brendshëm (AB) publik të Bashkisë, ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve nuk është bërë me program të miratuar nga Kryetari i Bashkisë ndërkohë për rekomandimet e pa zbatuara nuk është kërkuar zbatimi i tyre, në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”. (*Trajtuar në pikën III/D, faqet 168-173 të Raporti Përfundimtar të Auditimit*).

NIVELI I PRIORITETIT

I lartë.

7.1. Rekomandimi: Njësia e Auditit të Brendshëm, të marrë masa për rishikimin e planit vjetor dhe strategjik, duke planifikuar auditime në fusha me risk, si prokurimet publike, asetet e institucionit, rregullshmëria e veprimeve të kryera me bankë, duke i dhënë mbështetje titullarit të njësisë publike për arritjen e objektivave. Për rekomandimet e pazbatuara të merren masa që të kërkohe zbatimimi i tyre duke hartuar program të miratuar nga titullari institucionit.

Ne vazhdimësi

8. Gjetje nga auditimi: Rregullorja e vjetër e Bashkisë Korçë, miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr .2, datë 03.05.2013, nuk pasqyron përshkrimet e punës dhe detyrat individuale që duhen kryer nga çdo drejtori/ sektor/ njësi vartëse, pasi nuk janë vendosur rregulla të qarta, për të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit në funksion të menaxhimit financiar dhe kontrollit, kjo referuar dhe riorganizimit që njësia ka pësuar si rezultat i reformës territoriale.

Nuk janë përcaktuar rregulla për administrimin dhe ruajtjen e aktiveve të qëndrueshme sipas kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kap. III dhe nuk ka rregulla të shkruara lidhur me monitorimin e aktiveve të qëndrueshme sidomos për aktivet e dhëna me qira.

Nuk ka miratuar kodin e etikës profesionale për nivelin menaxhuese dhe për punonjësit e tjerë të njësisë, në kundërshtim me kërkesat e nenit 20, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar (*Trajtuar në pikën III/D, faqet 168-173 të Raporti Përfundimtar të Auditimit*).

NIVELI I PRIORITETIT

I mesëm

8.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Korçë të ngrejë një grup pune me specialist të fushës për hartimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit të Bashkisë Korçë, duke garantuar dhe përcaktuar qartë për secilin drejtori/ sektor/ njësi vartëse dhe punonjës, ndarjen e detyrave, hierarkinë dhe vendosur rregulla të qarta, për të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit në funksion të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

- Të miratojë kodin e etikës profesionale për nivelin menaxhuese dhe për punonjësit e tjerë të njësisë, duke mundësuar krijimin e një mjedisi të brendshëm stimulues (lidhur me statusin e punonjësve të rekrutuar).

- Të përcaktohen rregulla për administrimin dhe ruajtjen e aktiveve të qëndrueshme, mbrojtjen dhe monitorimin e tyre, nxjerrjen jashtë përdorimit sidomos për aktivet e dhëna me qira.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Korçë, u konstatua se më datën 31.12.2017 ka një numër të konsiderueshëm faturash të palikuiduara për vlerën totale 96,156,381 lekë, për shërbime dhe mallra të prokuruar, një pjesë e të cilave janë të trashëguara nga ish-komunat dhe një pjesë të krijuara pas reformës territoriale. Sipas shpjegimeve të subjektit (shoqëruar me dokumentacion mbështetës) gjendja e detyrimeve të palikujduara deri me datë 15.07.2018 (gjatë periudhës së auditimit), paraqitet në vlerën **26,100,273 lekë**, pasi ku vlera prej 60,767,389 lekë është likuiduar gjatë periudhës 1 Janar - 5 Korrik 2018, vlera prej 1,828,466 lekë është sistemuar në bilancin e Bashkisë të vitit 2017 (duke i hequr nga detyrimet), për shkak se kjo vlerë nuk mund të likuidohet, si rezultat i mangësive në dokumentacion të ish komunave, të dorëzuara pranë Bashkisë, ndërsa vlera prej 7,460,255 lekë përbëhet nga 2 objekte të ish komunave dhe konkretisht: “Sistemim, asfaltim i rrugës kryqëzimi Vithkuq- Lubonjë” në vlerë 5,872,111 lekë dhe “Objekti Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare Leka”, në vlerë 1,588,144 lekë, pritet velja e fondeve nga FZHR për likuidimin (*Trajtuar në pikën III/A (3.2), faqet 17-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

NIVELI I PRIORITETIT

I mesëm

9.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Korçë, të marrë masa për parashikimin e shpenzimeve në nivele të realizueshme për pagesën e faturave të pa likuiduara në vlerën totale **26,100,273 lekë**. Për këtë, bazuar në UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” dhe Udhëzimin Plotësues nr. 02, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91-*Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore*, të paraqesë në mbledhjen e këshillit bashkiak, një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, të hartojë grafik për shlyerjen e tyre, në përputhje me kërkesat ligjore për radhën e pagesave.

Brenda datës 31.12.2018

10. Gjetje nga auditimi: Me gjithë masat e marra nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Korçë, përsëri gjendja e subjekteve debitorë paraqitet e lartë, ku në fund të viti 2017 paraqiten **1872 subjekte** për vlerën **188,143,405 lekë** (*Trajtuar në pikën III/B (1.4), faqet 39-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

NIVELI I PRIORITETIT

I lartë

10.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Korçë, të marrë masa për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në vlerën **188,143,405 lekë**.

Bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, **të nxirren njoftim vlerësimit tatimore për debitorët dhe të ndiqen rrugët e mëposhtme:**

a- Tu dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhrat e bllokimit të llogarive bankare, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore RSH”.

b- Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ZVRPP (për pasuritë e paluajtshme), bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”.

c- Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, të bëhet kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal të R.SH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181, - Mospagimi i taksave dhe tatimeve.

d- Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Korçë, të listojë në mënyrë elektronike abonentët familjarë dhe të merren masa për arkëtimin e taksave të familjarëve, taksës së tokës nga fermerët e Njësive Administrative. Në zbatim të udhëzimit plotësues të Ministrisë Financave nr. 2, datë 19.01.2018 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018”, pika 76, sipas të dhënave që disponon Gjendja Civile, të njoftohen tatimpaguesit familjarë dhe bizneset me Njoftim vlerësimi tatimor edhe në median lokale (të Bashkisë) për të paguar detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak, nëpërmjet dërgimit të njoftim vlerësimit me anë të zyrës postare, për të gjitha llojet dhe shumën e taksave të papaguara, si taksën e tokës, banesave dhe tarifave etj.

Brenda datës 31.12.2018

11. Gjetje nga auditimi: Me shkresën nr. 768/9prot, datë 06.01.2016 Bashkisë Korçë i janë dërguar rekomandimet për përmirësimin e gjendjes nga auditimi i KLSH-ja.

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të dhëna, u konstatua se:

-Nga 1 masë përmisim ligjorë, pranuar nga subjekti Bashkia Korçë dhe zbatuar;

-Nga 30 masa organizative me vlerë 34,413 mijë lekë, pranuar nga subjekti duke zbatuar 26 masa, në proces 2 masa, nga e cila arkëtuar vlera 17,511 mijë lekë dhe në proces arkëtimi vlera 16,501 mijë lekë;

-Nga 4 masa shpërbllim dëmi me vlerë 3,950 mijë lekë, e papranuar nga subjekti dhe pazbatuar;

-Nga 4 masa administrative me vlerë 650 mijë lekë, pranuar dhe arkëtuar nga subjekti;

-Nga 14 masa disiplinore, pranuar nga subjekti dhe zbatuar (*Trajtuar në pikën IIIHD, faqet 175-180 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

NIVELI I PRIORITETIT

I mesëm

11.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Korçë të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara të KLSH dërguar me shkresën nr. 768/9, datë 06.01.2016 dhe rikërkuar me shkresën nr. 1113/142, datë 31.01.2017, duke u përqendruar në pikat 29 dhe 30 të masave organizative, në pikën C masa shpërblim dëmi ne vlerën 3,950 mijë lekë.

Brenda datës 30.11.2018

12. Gjetje nga auditimi: Në rakordimet e bërë midis vlerës së detyrimeve që paraqet Drejtoria e të Ardhurave Vendore dhe Drejtorisë së Financës në pasqyrat financiare (bilanci), në fund të periudhës 31.12.2017, konstatohet se ka mospërputhje për vlerën 51,490,018 lekë, e cila vjen si rezultat se nga Drejtoria e Financës nuk ka reflektuar detyrimet e fund vitit 2017 për vlerën 47,033,021 lekë dhe të penaliteteve për mos pagesë në kohë të detyrimeve (llogaritur nga sistemi në vlerën 4,458,997 lekë) *(Trajtuar në pikën III/B (1.4), faqet 39-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

NIVELI I PRIORITETIT

I mesëm

12.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave Vendore, të marri masa për saktësimin dhe kontabilizimin e vlerës së debitorëve të subjekteve privat në fund të periudhave ushtrimore, si dhe të bëjë regjistrimin në llogaritë përkatëse (468) të vlerës detyrimit prej 51,490,018 lekë.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2018

13. Gjetje nga auditimi: Me vendimin nr. 99, datë 13.12.2013 “Mbi parkimet me pagesë në rrugë”, Këshilli Bashkiak ka miratuar në parim studimin e fizibilitetit “Për partneritetin publik-privat për parking të lehtë dhe investimet”. Sipas të dhënave të Drejtorisë së Financës, konstatohet se të ardhura e realizuara nga kjo kontratë janë në vlerën 13,016,400 lekë për vitin 2016, ku shoqëria ka përfituar 8,851,152 lekë dhe Bashkia Korçë ka përfituar 4,165,248 lekë dhe për vitin 2017 në shumën 12,764,840 lekë, ku shoqëria ka përfituar 8,680,091 lekë dhe Bashkia Korçë ka përfituar 4,084,749 lekë.

Referuar të dhënave të studimit të fizibilitetit, në vitin e parë pritet që bashkia të përfitonte afërsisht 11,400,000 lekë, ndërsa subjekti pas zbritjes së shpenzimeve një fitim neto 7,150,000 lekë. Konstatohet se pas 3 vitesh nga fillimi i zbatimit të parkimit me pagesë, bashkia përfiton një vlerë prej 4,084,749 lekë për vitin 2017, ose 7.3 milionë lekë më pak nga parashikimi.

Shihet se përfitimi i bashkisë është shumë herë më pak se sa ai i parashikuar, ndryshe rezulton të jetë situata e përfitimit financiar të subjektit privat e cila sipas tabelave të rakordimeve është në nivelin e parashikuar të 8 milion lekë të ardhura.

Treguesit e mësipërm tregojnë se administrimi i kësaj taksa nga ky operatorë nuk është në nivelin e kërkuar dhe nga personat përgjegjës të Bashkisë Korçë nuk janë kryer në vazhdimësi kontrole në lidhje me eC.....Inë e kësaj takse, kjo për të rritur nivelin e të ardhurave të parashikuara në fillim sipas studimit të fizibilitetit.

Referuar të dhënave të evidencës së fund vitit 2017, mbi të ardhurat e realizuar nga taksa e parkimit në rrugë, konstatohet se nga vetë administrata e Bashkisë Korçë është arkëtuar një vlerë prej 4,500,000 lekë ose më shumë agjenti “A.....y” (4,084,749 lekë), për vlerën **415,251 lekë**, ndërkohë që numri i vendparkimeve që administron agjenti “A.....y” (432 vendparkime) është shumë herë më i lartë se numri i vendparkimeve që administron vetë Bashkia Korçë (193 vendparkime), gjithsej më shumë për 239 vendparkimeve ose 55.3%. *(Trajtuar në pikën III/B (1.4), faqet 39-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

NIVELI I PRIORITETIT

I mesëm

13.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Korçë të ngrëjë një grup pune me specialit të fushës, që brenda një afati tre mujorë të monitorojë aktivitetin e agjenti “A.....y” për menaxhimin e taksës së parkimit në rrugë mbi nivelin e të ardhurave që ajo realizon.

Në rast se treguesit ekonomik nuk janë ato të parashikuar në fillim të kontratës, ti kërkohet Këshillit Bashkiak me relacion shpjeguar prishja e kontratës dhe menaxhimi i saj nga vetë Bashkia ose zhvillimi i procedurave të reja në zbatim dhe të rekomandimit të KLSH (nr. 30 masa organizative), dërguar me shkresën nr. 768/9, datë 06.01.2016, rikërkuar me shkresën nr. 1113/142, datë 31.01.2017.

Deri me datë 30.11.2018

14. Gjetje nga auditimi: Në ekonominë Pyjore të Bashkisë Korçë, kryejnë aktivitet për shfrytëzim karriere 8 subjekte pa kontratë, të cilët kanë në përdorim 82.97 ha sipërfaqe pyjore/kullosore të shfrytëzueshme.

Për këto sipërfaqe nga Agjencia e Pyjeve, nuk janë zbatuar procedurat e pakësimit të sipërfaqes së fondit pyjor/kullosor, siç përcaktohet në nenin 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar; pika 6 e nenit 17, të ligjit nr. 9693 datë 19.03.2007 “Për Fondin Kullosor”; pikat 3, 7, 9,10,11 dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008 “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2015, si dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10.2008 “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor” (Trajtuar në pikën III/B (1.4), faqet 39-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

NIVELI I PRIORITETIT

I mesëm

14.1. Rekomandimi: Bashkia Korçë nëpërmjet strukturave përkatëse, të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke i hequr nga fondi pyjorë dhe kullosorë, si dhe t'i kërkohet Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), bllokimin e veprimtarisë së kompanive minerare deri në lidhjen e kontratave për shfrytëzimin e sipërfaqes pyjore prej 82.97 ha dhe realizimin e të ardhura nga shfrytëzimi i këtyre sipërfaqeve.

Brenda datës 30.11.2018

15. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak të analizojë Raportin Përfundimtar të Auditimit të kryer në Bashkinë Korçë për periudhën e veprimtarisë ekonomike 01.01.2016 – 31.12.2017, duke analizuar të gjitha shkeljet dhe rekomandimet e dhëna nga KLSH për nxjerrjen e përgjegjësive të personave përgjegjës dhe marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve dhe përmisimin e punës në të ardhmen, kjo në zbatim të pikës 4 e nenit 50, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”.

Menjëherë

16. Rekomandim: Në rastin e fillimit të procedurave gjyqësore në funksion të zbatimit të rekomandimit për “Masa për shpërblim dëmi”, nga ana e Bashkisë Korçë, të kërkohet prezenca e KLSH-së, si palë e tretë në proces gjyqësor, duke informuar njëkohësisht KLSH-në, në lidhje me eC.....Inë dhe zhvillimet përgjatë procesit gjyqësor.

C/I. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) -Të drejtat e KLSH dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 ”Për menaxhimin e

aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga **Titullari i Njësisë Publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **25,783,615 lekë**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Në testimet e kryera në hyrje/ daljet për muajit Janar, Maj dhe Gusht 2017, për likuidimet e mallrave të blerë nga të tretët dhe të dhuruara nga donatorët, u konstatua se nga Bashkia Elbasan janë bërë dalje (pa pagesë) në adresë të Bashkisë Korçë, tabela informuese për autobuzat e linjave dhe tabela informuese për stacionet e autobuzave. Nga Bashkia Korçë janë dokumentuar me fletë hyrjen nr. 35, datë 11.05.2017 “Tabela informuese për autobuzat e linjave” me vlerë 1,800,000 lekë.

Edhe pse Bashkia Korçë i ka marrë falas nga Bashkia e Elbasanit, konstatohet se kontrata datë 15.12.2006 nuk është zbatuar në afatin 12 mujor të përcaktuar për vendosjen e tabelave, afati ky i përfunduar 15.12.2017, në kundërshtim me pikën (b) e nenit 20 të kontratës, duke mos bërë të mundur llogaritjen e kamatëvonesës për mos mbylljen në afat të punimeve në vlerën **1,484,500 lekë, dëm ekonomik** (Trajtuar në pikën III/A (3.2), faqet 17-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

NIVELI I PRIORITETIT

I lartë

1.1. Rekomandimi: Bashkia Korçë në bashkëpunim me Bashkinë Elbasan, të marrë masa administrative e ligjore ndaj kontraktuesit JV “H.....m” dhe “S.....a”, për mos zbatim të kushteve të kontratës datë 15.12.2006, për vendosjen e tabelave informuese në stacionet e autobuzëve urban dhe interurbane në Bashkinë Korçë.

Të ndiqen të gjitha procedurat administrative e ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës **1,484,500 lekë** nga JV “H.....M” dhe “S.....a”, si dhe të llogaritet kamat vonesat shtesë deri në momentin e vendosjen e tabelave informuese.

Brenda datës 31.10.2018

2. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e zbatimit të punimeve të ndërtimit me objekt “*Rikonstruksion i veprave ujitëse në zonën jugperëndimore të Fushës së Korçës*”, me vlerë 9,614,884 lekë me TVSH, sipas kontratës datë 21.03.2017 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Korçë dhe shoqërisë zbatuese “N.....A”, u konstatua se për zërat e punimeve: (Zëri (3.240) *Beton për veshje C 12/15, në Leshnje, Pulahe dhe Bulgarec; zëri (An) Urë H.D 1 m, në Dvoran*), janë likuiduar punime të pakryera me diferenca në volume në shumën **287,370 lekë pa TVSH**, duke shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit, në kundërshtim me nenin 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar (Trajtuar në pikën III/C (1.4), faqet 156-168 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

NIVELI I PRIORITETIT

I lartë

2.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës **287,370 lekë pa TVSH** nga shoqëria “N.....A” .

Brenda datës 31.10.2018

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit me objekt “*Rehabilitimi i rrjetit të kanaleve ujitës Bashkia Korçë*”, të kontratës datë 21.03.2017 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Korçë dhe JV “A.....T” & “A.....02” përfaqësuar nga “A.....02”, me vlerë 21,243,948 lekë me TVSH, u konstatua se, për zërat e punimeve: (Zëri 5. *Luster çimento dhe zëri 7. Beton C 12/15 për veshjen e kanalit, në urat me hapësirë drite 5 m;*

zëri 6. Luster çimento, zëri 7. Hidroizolim me 3 duar bitum dhe zëri 8. Beton C 12/15 për veshjen e kanalit, në urat me hapësirë drite 2 m), janë likuiduar për punime të pakryera dhe diferenca në volume zëra punimesh në shumën **298,900 lekë pa TVSH** duke shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxheti. Sa më sipër nuk është në përputhshmëri me paragrafin e tretë të nenit 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar (Trajtuar në pikën III/C (1.4), faqet 156-168 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

NIVELI I PRIORITETIT

I lartë

3.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës **298,900 lekë pa TVSH** nga shoqëritë JV “A.....T” & “A.....02”.

Brenda datës 31.10.2018

4. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurës me objekt “Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare Ranovik” në ish- Komunën Drenovë, me fond limit 7,526,667 lekë dhe fitues operatorin “K.....N” për vlerën e kontratës prej 5,480,800 lekë, konstatohet se në zbatimin e kontratës datë 08.01.2014, afati për përfundimin e punimeve është 60 ditë kalendarike nga data e lidhjes së kontratës (datë 06.08.2013). Nga dokumentacioni që shoqëron dosjen e subjekti të audituar, konstatohet se punimet kanë përfunduar me datë 08.01.2014, pra jo sipas afatit të përcaktuar në dokumentet e tenderit i cili ka qenë 60 ditë kalendarike (nga data 07.08.2013 fillim punimesh deri datë 07.10.2013 sipas kushteve të DST).

Pra punimet kanë përfunduar jashtë afatit të përcaktuar në DST me **90 ditë vonesë**, për të cilën nga mbikëqyrësi i punimeve TH.F me nr. licenc MK 373/1, datë 21.05.2013, nuk është bërë i mundur llogaritja e penalitetit në vlerën **1,564,568 lekë**, me dëm më buxhetin e ish- Komunës Drenovë (Trajtuar në pikën III/C nën-pika 1.3, faqet 106-115 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

NIVELI I PRIORITETIT

I lartë

4.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës **1,564,568 lekë** nga shoqëria “K.....N”.

Brenda datës 31.10.2018

5. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurës me objekt “Blerje tubo” në ish- Komunën Drenovë, me fond limit 2,189,653 lekë dhe fitues operatorin “O...A” për vlerën 1,892,000 lekë, konstatohet se afati për dorëzimin e mallit është deri me datë 31.08.2014 nga data e lidhjes së kontratës datë 03.07.2015.

Subjekti ka paraqitur mallin për likuidim sipas faturës nr. 35, datë 31.08.2014 dhe fletë hyrjes në ish- komunë nr. 33, datë 31.08.2014 për shumën 830,400 lekë me TVSH.

Nga ana e komisionit të marrjes në dorëzim të mallit, nuk është hartuar asnjë procesverbal mbi cilësinë dhe specifikimet teknike të marrjes së mallit si dhe nuk është llogaritur penaliteti për dorëzim me vonesë të mallit sipas kushteve të DST dhe kontratës.

Konstatohet se jo i gjithë sasia është dorëzuar në afatin e caktuar datë 31.08.2014, pasi një sasi me vlerë 1,440,000 lekë (tubo d=314 korogato prej 1600 ml është dorëzuar në dhjetor 2014, sipas faturës tatimore nr. 8, datë 13.12.2014 dhe FH nr. 52, dt. 13.12.2014) ose me **106 ditë vonesë** nga momenti që duhet të paraqitej malli, dhe nuk është bërë i mundur llogaritja e penalitetit në masën 4/1000/ditë, në zbatim të nenit 45 të kushteve të kontratës paraqitur në DST, për vlerën **610,560 lekë**, veprim financiar me pasoja negative me dëm më buxhetin e ish- Komunës Drenovë (Trajtuar në pikën III/C nën-pika 1.3, faqet 106-115 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

NIVELI I PRIORITETIT

I lartë

5.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës **610,560 lekë** nga shoqëria “O....A”.

Brenda datës 31.10.2018

6. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurës me objekt “*Rikonstruksion i qendrës së Komunës Vithkuq + rrugë lagje Saraq, Grekas, fshati Vithkuq*” në ish- Komunën Vithkuq, me fond limit 2,833,165 lekë dhe fitues BOE “V.....A + K.....N” për vlerën 1,920,990 lekë, konstatohet se nuk janë respektuar afatet e përfundimit të punimeve në afatin e përcaktuar në kontratën nr. 2, datë 07.07.2014 (nga data 07.07.2014 – 07.08.2014), duke përfunduar me datë 11.09.2014 ose me **34 ditë vonesë**.

Për mos përfundimin e punimeve në afat, ndaj shoqërisë “V.....A” që është përfaqësuesi kryesor i kryerjes së punimeve nuk janë përlllogaritur penalitetet në zbatim të pikës 18, të kontratës datë 07.07.2014 në vlerën **78,376 lekë, dëm ekonomik** (*Trajtuar në pikën III/C nënpika 1.3, faqet 117-133 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

NIVELI I PRIORITETIT

I lartë

6.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa për ti kërkuar shoqërisë “V.....A”, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës **78,376 lekë**.

Brenda datës 31.10.2018

7. Gjetje nga auditimi: Në ish- Komunën Vithkuq në auditimin e procedurës së prokurimit me objekt “*Sistemim i rrugëve në fshatin Lubonjë, Rehovë, Leshnjë*” me fond limit 2,239,471 lekë, ku fitues është shpallur BOE “A.....k + R.....a” me vlerë kontrate 2,097,290 lekë, konstatohet se:

Bashkimi i Operatorit Ekonomik i shpallur fitues “A.....k +Ra”, nuk plotëson kriteret e miratuara në DST, si: *-Kontrata e bashkëpunimit nuk është në zbatim të LPP, pasi përqindja midis dy shoqërive e cila është 90% shoqëria “A.....K” dhe 10% shoqëria “R,,,,,,,a K.....a”, nuk janë ndarë zërat e preventivit se cilat punime do ketë një shoqëri e cila tjetra; -Shoqëria “R.....a K.....a”, nuk plotëson kriterin e veçantë në lidhje me licencën profesionale (pika 2.1/b e DST), pasi nuk disponon kategoritë e punimeve NP-5, NP-9 dhe NS-18; -Nuk plotëson piken 2.3/d e DST.*

Nga të dy shoqëritë nuk janë paraqitur dokumente që tregojnë se në licencat e shoqërive ka ing. Ndërtimi dhe Ing. Topograf (licencat përkatëse).

Në lidhje me shoqërinë “V.....A” e skualifikuar nga KVO, mangësitë e evidentuara nuk qëndrojnë, pasi nga verifikimi në sistem të dy dokumentet janë paraqitur nga shoqëria.

Si rezultat KVO ka shpallur si fitues BOE “A.....k + R.....a” me ofertë më të lartë se operatori “V.....A” për vlerën **88,000 lekë**, veprime me efekt negativ me dëm në buxhetin e ish-Komunës Vithkuq (*Trajtuar në pikën III/C nënpika 1.3, faqet 117-133 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

NIVELI I PRIORITETIT

I lartë

7.1. Rekomandimi: Bashkia Korçë të marrë masa të analizojë me grup pune të veçantë duke nxjerrë shkaqet dhe arsyet për dëmin ekonomik të shkaktuar prej **88,000 lekë**, ndaj punonjësve dhe drejtuesit përgjegjës në procedurën me objekt “*Sistemim i rrugëve në fshatin Lubonjë, Rehovë, Leshnjë*”, të zhvilluar në ish- Komunën Vithkuq.

Brenda datës 31.10.2018

8. Gjetje nga auditimi: Në ish- **Komunën Voskop** auditimin e procedurës së prokurimit me objekt “*Rrethim i fushës te stadiumit fshati Polenë*”, me fond limit 1,666,250 lekë, ku fitues është shpallur operatori “A.....I” me vlerë kontrate 1,653,910 lekë, konstatohet se:

Referuar dokumentacioni të paraqitur në sistemin APP, si dhe arsyes së skualifikimit të shoqërisë “S.....K”, rezulton se kriteri për të cilën është skualifikuar nuk është kërkesë e DST, pasi në DST është kërkuar që OE të paraqes certifikatë *ISO (materialët te jene te standardizuara dhe te prodhuara me ISO 9001-2008)*, gjë të cilën shoqëria e ka paraqitur.

Në këto kushte skualifikimi i shoqërisë “S.....K” është i padrejtë dhe nisur nga kriteri kryesore “*Çmimi më i leverdishëm*”, KVO duhet të shpallte fitues këtë shoqëria për të bërë të mundur shmangien e efektit negativ të përdorimit të fondeve me dëm për vlerën **313,020 lekë** (1,653,910 – 1,340,890), si diferenca midis ofertave të OE, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1 “Objekti dhe qëllimi” pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 “Parimet e përzgjedhjes” germa (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46, 53 dhe 55 (*Trajtuar në pikën III/C nënpika 1.3, faqet 139-146 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

NIVELI I PRIORITETIT

I lartë

8.1. Rekomandimi: Bashkia Korçë të marrë masa të analizojë me grup pune të veçantë duke nxjerrë shkaqet dhe arsyet për dëmin ekonomik të shkaktuar **prej 313,020 lekë**, ndaj punonjësve dhe drejtuesit përgjegjës në procedurën me objekt “*Rrethim i fushës te stadiumit fshati Polenë*”, të zhvilluar në ish- Komunën Voskop.

Brenda datës 31.10.2018

9. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurës me objekt “*Blerje Automjeti*” në ish- **Komunën Lekas**, me fond limit 750,000 lekë dhe fitues OE “R.....J” për vlerën 749,500 lekë, konstatohet se nuk janë respektuar afatet e dorëzimit të mallit përcaktuar në kontratën nr. --, datë 23.07.2013 (27 ditë nga momenti i nënshkrimit të kontratës).

Sipas dokumentacionit në dosje, shoqëria ka dorëzuar mallin me faturën e TVSH nr. 29 (seri 06056622), datë 11.10.2013 për vlerën 899,400 lekë, ose më shumë seç parashikon kontrata dhe kërkesat e DST për **51 ditë vonesë** (nga data 20.08.2013 deri me datë 11.10.2013). Detyrimi për kamatën e pallogaritur paraqitet në vlerën **183,478 lekë** (*Trajtuar në pikën III/C nënpika 1.3, faqet 133-139 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

NIVELI I PRIORITETIT

I lartë

9.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa për ti kërkuar shoqërisë “R.....J”, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e **vlerës 183,478 lekë**.

Brenda datës 31.10.2018

10. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurës me objekt “*Ndërtim ujësjellësi fshati Barc*” të zhvilluar në ish- **Komunën Bulgarec** (viti 2014), me fond limit 1,537,642 lekë, ku fitues është shpallur BOE “A.....I + A.....X” për vlerën 1,147,360 lekë, konstatohet se nuk janë zbatuar afatet për kryerjen e punimeve përcaktuar në kontratën nr. --, datë 29.10.2014 (10 ditë nga momenti i nënshkrimit të kontratës).

Nga dokumentacioni që shoqëron dosjen e subjekti të audituar, konstatohet se punimet kanë përfunduar me datë 21.12.2014 (sipas shkresës njoftim për përfundim punimesh të mbikëqyrësit të punimeve P.P. dhe administratorit të shoqërisë “A.....I” A.....I), pra jo sipas afatit të përcaktuar në dokumentet e tenderit i cili ka qenë 10 ditë kalendarike nga momenti i lidhjes së kontratës (nga data 29.10.2014 fillim punimesh deri datë 08.11.2014 sipas kushteve të DST).

Nga sa trajtuar më sipër, rezulton se punimet kanë përfunduar jashtë afatit të përcaktuar në DST me **34 ditë vonesë** (nga data 08.11.2014 deri datë 21.12.2014), për të cilën nga ish- Komuna Bulgarec dhe mbikëqyrësi i punimeve P.P. me nr.licenc Z-2117/4, nuk është bërë i mundur llogaritja e penaltetit në vlerën **156,041 lekë** (Trajtuar në pikën III/C nën-pika 1.3, faqet 146-156 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

NIVELI I PRIORITETIT

I lartë

10.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa për ti kërkuar shoqërisë “**A.....I + A.....X**”, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës **156,041 lekë**.

Brenda datës 31.10.2018

11. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurës me objekt: “*Rikonstruksion shkolla e mesme Voskop*” të zhvilluar në ish- **Komunën Voskop** (viti 2014), me fond limit 30,567,716 lekë, ku fitues është shpallur OE “**XH.....O**”, me vlerë 29,900,300 lekë, u konstatua se Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) padrejtësisht ka kualifikuar dhe shpallur fitues shoqërinë “**XH.....O**”, me kritere të paplotësuar, si: -*Të ardhurat sipas pasqyrave financiare të viteve respektive; -Nga shoqëria nuk është paraqitur vërtetimi për taksat lokale në vendet ku shoqëria ushtron aktivitet, kjo referuar pikës 2/a të DST; -Nuk paraqet dokumentacion për ing. Mjedisi dhe ing. Topograf, veprime me efekt negativ në përdorimin e fondeve për vlerën **8,388,710 lekë**, të llogaritur si diferencë e vlerave të ofertave ekonomike, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 1, “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, germa a, b, d dhe dh, dhe Neni 2 “Parimet e përzgjedhjes”, germa a, b dhe c, Neni 24 “Anulimi i një procedure prokurimi” dhe nenin 46 “Kualifikimi i ofertuesve” (Trajtuar në pikën III/C nën-pika 1.3, faqet 13-146 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

NIVELI I PRIORITETIT

I lartë

11.1. Rekomandimi: Bashkia Korçë të marrë masa të analizojë me grup pune të veçantë duke nxjerrë shkaqet dhe arsyet për efektin financiar negativ të shkaktuar prej **8,388,710 lekë**, ndaj punonjësve dhe drejtuesit përgjegjës në procedurën me objekt “*Rikonstruksion shkolla e mesme Voskop*”, të zhvilluar në ish- Komunën Voskop.

Brenda datës 31.10.2018

12. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt “*Ndërtim ujësjellësi fshati Lumalas - Biran*”, të zhvilluar në ish- **Komunën Bulgarec** (viti 2013), me fond limit 12,031,554 lekë, ku fitues është shpallur bashkimi operatorëve “**A.....I & SH.....M**”, me vlerë 11,507,146 lekë, u konstatua se BOE “**A.....I & SH.....M**” i shpallu fitues nuk plotëson kriteret e DST, si: **a-Shoqëria “A.....I” e cila sipas kontratës së bashkëpunimit nr. 1298/481, datë 25.05.2013 ka 55 %, nuk përmbush këto kritere:** -Nuk licencën profesionale nuk ka këto kategori punimesh NP-1B; NP-7C; NP-11B; NP-12B; NS-9A; NS-14A;NS-16A dhe NS-18A; -Në punimet e ngjashme nuk paraqet kontratën me sipërmarrësin për objektin “*Ndërtim ujësjellësi në fshatin Bare, Komuna Bulgarec*” me vlerë 28,512,939 lekë, **kusht për të cilën është skualifikuar dhe BOE “L.....I + C.....I” me ofertë më të leverdishme;** -Nuk plotëson numrin e punonjësve për periudhën Janar 2012 – Shkurt 2013” prej 17 punonjësish; -Nuk paraqet stafin e nevojshëm inxhinierik siç kërkohet në DST, **kriter për të cilin është skualifikuar BOE “V.....A + A.....A”;** -Nuk paraqet pagesën e taksave vendore në vendet e ushtrimit të aktivitetit sipas QKR; -Nuk paraqet certifikatë ISO 14001:2004 dhe 18001:2007.

b-Shoqëria “SH.....M” e cila sipas kontratës së bashkëpunimit nr. 1298/481, datë 25.05.2013 ka 45 %, nuk përmbush këto kritere: -Nuk paraqet vërtetim për xhiron e tre viteve të fundit nga administrata tatimore, siç kërkohet në pika 2.2/1 të DST; -Stafi inxhinierik i paraqitur, konstatohet se paga sipas kontratës së punës nuk përputhet me pagën në listpagesës e sigurimeve

shoqërore; -Pasqyrat financiare të vitit 2012 nuk është certifikuar me ekspert siç kërkohet në DST;

-Të dy shoqëritë së bashku nuk plotësojnë kriterin për makineri, konkretisht “Makineri ngjitëse HDPE me elektrofuzion dhe ballorë copë 4 (katër), ndërkohë që nga shoqëritë janë paraqitur 3 (tre)copë.

Nga KVO janë mbajtur dy standarde, pasi për të njëjtin mangësi (Nuk plotëson stafin inxhinierik të kërkuar) është skualifikuar BOE “V.....A + A.....Y.II”, por me çmim, më të leverdishëm (7,094,371 lekë) se BOE shpallur fitues, duke mos vlerësuar kriterin kryesore “Çmimi më i leverdishëm”, për të bërë të mundur shmangien me efekt negativ të fondeve publike në vlerën **4,412,775 lekë** (11,507,146 – 7,094,371) (Trajtuar në pikën III/C nënpika 1.3, faqet 13-146 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

NIVELI I PRIORITETIT

I lartë

12.1. Rekomandimi: Bashkia Korçë të marrë masa të analizojë me grup pune të veçantë duke nxjerrë shkaqet dhe arsyet për efektin financiar negativ të shkaktuar prej **4,412,775 lekë**, ndaj punonjësve dhe drejtuesit përgjegjës në procedurën me objekt “Ndërtim ujësjellësi fshati Lumalas - Biranj”, të zhvilluar në ish- Komunën Bulgarec.

Brenda datës 31.10.2018

13. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt “Ndërtim ujësjellësi fshati Bulgarec, Komuna Bulgarec”, të zhvilluar në ish- Komunën Bulgarec (vitin 2013), me fond limit 25,019,235 lekë, ku fitues është shpallur bashkimi operatorëve “C....I & L....I” me vlerë 24,475,015 lekë, u konstatua se nuk plotëson të gjitha kërkesat e DST, konkretisht:

a-Shoqëria “L....I” e cila sipas kontratës së bashkëpunimit nr. 1298/481, datë 25.05.2013 ka 49 %, nuk përmbush këto kriteret: -Nuk licencën profesionale nuk ka këto kategori punimesh NP-1B; NP-7C; NP-11B; NP-12B; NS-8Q; NS-9A; NS-14A;NS-16A dhe NS-18A, siç kërkohet në DST, kjo pasi sipas kontratës së bashkëpunimit kjo shoqëri ka marrë përsipër 49% e punimeve në të gjithë zërat e preventivit; -Nuk paraqet pagesën e taksave vendore në vendet e ushtrimit të aktivitetit; -Nuk paraqet certifikatë ISO 14001:2004 dhe 18001:2007.

b-Të përbashkëta:

-Stafi inxhinierik i cili është i mangët, nuk janë shoqëruar me licencat përkatëse nga MPPTT, siç kërkohet në pikën 2.2.3 të DST, kriter të për cilën janë skualifikuar dhe OE me oferta më të leverdishme; -Nuk paraqesin ing. Hidroteknik, ing. Ndërtimi dhe ing. Gjeodet siç kërkohet në pikën 2.2.3 të DST; -Marrëveshja e bashkëpunimit midis dy operatorëve nuk është sipas kërkesave ligjore, pasi nuk janë ndarë zërat e punimeve midis dy shoqërive se cilat punime do kryhej njëri operator dhe cili tjetri;

-Asnjë nga shoqëritë nuk paraqet certifikatë ISO 18001:2007.

KVO nuk ka vlerësuar drejt bashkimin e operatorëve JV “C....I + L....I”, pasi ka mangësi në plotësimin e kriterëve. Gjykojmë se nga KVO janë mbajtur dy standarde, pasi për të njëjtin mangësi (Nuk plotëson stafin inxhinierik të kërkuar) është skualifikuar JV “V.....A + A.....Y.II”, por me çmim më të leverdishëm (16,577,698 lekë), duke mos vlerësuar kriterin kryesore që është “Çmimi më i leverdishëm”, për të bërë të mundur shmangien me efekt negativ të fondeve publike në vlerën **7,917,317 lekë** (24,475,015– 16,557,698), si diferenca midis ofertave të OE, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1 “Objekti dhe qëllimi” pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 “Parimet e përzgjedhjes” germa (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46, 53 dhe 55 (Trajtuar në pikën III/C nënpika 1.3, faqet 13-146 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

NIVELI I PRIORITETIT

I lartë

13.1. Rekomandimi: Bashkia Korçë të marrë masa të analizojë me grup pune të veçantë duke nxjerrë shkaqet dhe arsyet për efektin financiar negativ të shkaktuar prej **7,917,317 lekë**, ndaj punonjësve dhe drejtuesit përgjegjës në procedurën me objekt “Ndërtim ujësjellësi fshati Bulgarec, Komuna Bulgarec”, të zhvilluar në ish- Komunën Bulgarec.

Brenda datës 31.10.2018

C/II. PËRDORIM JO ME EFEKTIVITET, EFICENCË DHE EKONOMICITET I SHPENZIMEVE NË FUSHËN E PROKURIMEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurave të prokurimeve, të zhvilluara në **Bashkinë Korçë**, u konstatua se **4 procedura** prokurimi janë kryer në kundërshtim me nenin 2, “Parimet e përzgjedhjes”, nenin 55, “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, nenin 24, “Anulimi i një procedure prokurimi” dhe pika 5 e nenit 53, “Shqyrtimi i ofertave”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, pasi:

Operatorët ekonomikë janë shpallur fitues edhe pse kanë mangësi në dokumentacionin e paraqitur sipas kërkesave të DST, të miratuara nga Autoriteti Kontraktor (AK) dhe Njësia e Hartimit të Dokumenteve të Tenderit (NJHDT), veprime të cilat kanë ndikuar në mos përdorim me efektivitet, efencë dhe ekonomikitet të shpenzimeve në fushën e prokurimit, për vlerën e fondit limit prej 519,238,412 lekë, duke mos vlerësuar kriterin kryesorë “Çmimi më i leverdishëm”, dhe favorizuar operatorët ekonomikë në shumën 45,249,322 lekë, si më poshtë:

1. Në procedurën e prokurimit me objekt “*Rikonstruksion i Teatrit A.Z.Çajupi, faza e dytë*”, Bashkia Korçë, me fond limit 105,769,662 lekë, zhvilluar në vitin 2017, fitues OE “XH....O”, me vlerë 103,302,255 lekë, u konstatua se: KVO padrejtësisht ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE “XH....O”, me vlerë 103,302,255 lekë, pasi nuk ka plotësuar kriterin për fabrikën e asfaltobetonit, duke vepruar në kundërshtim me kriteret e kërkuara në DST. Si pasojë, tenderi duhej anuluar dhe zhvilluar procedurë e re, çka nuk ka ndodhur, mos përdorim me efektivitet, të fondeve të llogaritura si diferencë e vlerave të ofertave ekonomike në **vlerën 25,634,352 lekë**.

2. Në procedurën e prokurimit me objekt “*Rikualifikimi urban i zonës përreth “Qytezës të fëmijëve” Bashkia Korçë*”, me fond limit 330,162,662 lekë, zhvilluar në vitin 2016, fitues “G.....Y”, me vlerë 306,719,507 lekë, u konstatua se: KVO padrejtësisht ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE “G.....Y”, me vlerë 306,719,507 lekë, pasi nuk ka plotësuar kriteret e kërkuara në DST. Si pasojë, tenderi duhej anuluar dhe zhvilluar procedurë e re, çka nuk ka ndodhur, mos përdorim me efektivitet, të fondeve të llogaritura si diferencë e vlerave të ofertave ekonomike në **vlerën 9,306,772 lekë**.

3. Në procedurën e prokurimit me objekt “*Skema ujitëse me kanalet e Gjançit. 11 kanale sekondare dhe vepra arti, është rehabilitim i pjesshëm i skemës ujitëse te rezervuarit te Gjançit*”, Bashkia Korçë, me fond limit 53,916,420 lekë, zhvilluar në vitin 2017, fitues BOE “S.....J & “A.....02”, me vlerë 36,153,542 lekë, u konstatua se: KVO padrejtësisht ka kualifikuar dhe shpallur fitues BOE “S.....J” & “A.....02”, me vlerë 36,153,542 lekë, pasi nuk ka kategoritë e licencës profesionale të shoqërisë duke vepruar në kundërshtim me kriteret e kërkuara në DST. Si pasojë, tenderi duhej anuluar dhe zhvilluar procedurë e re, çka nuk ka ndodhur, mos përdorim me efektivitet, të fondeve të llogaritura si diferencë e vlerave të ofertave ekonomike në **vlerën 9,641,456 lekë**.

4. Në procedurën e prokurimit me objekt “*Rikonstruksion i rrugës Voskopojë –Lekas, Loti i parë*”, Bashkia Korçë, me fond limit 29,389,668 lekë, zhvilluar në vitin 2016, fitues BOE “A.....N” & “K.....A”, me vlerë 17,628,087 lekë, u konstatua se: KVO padrejtësisht ka kualifikuar dhe shpallur fitues BOE “A.....N” & “K.....A”, me vlerë 17,628,087 lekë, pasi nuk ka plotësuar kriterin për fabrikën e asfaltobetonit, duke vepruar në kundërshtim me kriteret e kërkuara në DST. Si pasojë, tenderi duhej anuluar dhe zhvilluar procedurë e re, çka nuk ka ndodhur, mos përdorim me efektivitet, të fondeve të llogaritura si diferencë e vlerave të ofertave

ekonomike në vlerën **666,742 lekë** (Trajtuar në pikën III/C, faqet 51-106 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

NIVELI I PRIORITETIT

I lartë

1.1. Rekomandimi: Bashkia Korçë nëpërmjet strukturave përkatëse, të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave të kualifikimit dhe shpalljes fitues të operatorëve ekonomik në kushtet e mos plotësimit të kriterëve të miratuara në DST, në 4 procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negativ me vlerë **45,250,322 lekë**.

Në vijimësi

C/III. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DUKE RITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA)

1. Gjetje nga auditimi: Në testet e zhvilluar në fushën e zbatimit të kontratave të qirasë për vitin 2017, u konstatua se nga subjektet që cilët kanë lidhur kontrata me Bashkisë Korçë për shfrytëzimin e sipërfaqeve të objekte, pyjore/ kollusore dhe tokë bujqësore nuk është bërë i mundur likuidimi i detyrimeve në vlerën 5,324,763 lekë, sipas kushteve të kontratave individuale të lidhura.

Gjithashtu për disa kontrata vlera e qirasë së tyre nuk është përlllogaritur sipas përcaktimeve të VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, lidhja nr. 2 për vlerën 988,103 lekë. Gjithsej detyrim i munguar në të ardhurat e Bashkisë Korçë për vlerën **6,312,866 lekë** (Trajtuar në pikën III/A (1.4), faqet 39-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

NIVELI I PRIORITETIT

I lartë

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të ndjekin të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për sanksionimin dhe arkëtimin e **vlerës 6,312,866 lekë**, si detyrim ligjorë kontraktual midis dy subjekteve. Në rast mos pagesë të detyrimeve, të shikohet mundësia e prishjes së kontratës dhe lidhjes së kontratave të reja me subjekte të tjera që paraqesin interes për këto prona.

Brenda datës 31.10.2018

2. Gjetje nga auditimi: Me gjithë masat e marra nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Korçë, përsëri gjendja e subjekteve debitorë paraqitet e lartë, ku në fund të viti 2017 paraqiten **1872 subjekte** për vlerën **188,143,405 lekë** (Trajtuar në pikën III/B (1.4), faqet 39-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

NIVELI I PRIORITETIT

I lartë

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Korçë, të marrë masa për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore në vlerën **188,143,405 lekë**.

Bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, **të nxirren njoftim vlerësimit tatimore për debitorët dhe të ndiqen rrugët e mëposhtme:**

a- Tu dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhrat e bllokimit të llogarive bankare, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore RSH”.

b- Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ZVRPP (për pasuritë e paluajtshme), bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”.

c- Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, të

bëhet kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181, - Mospagimi i taksave dhe tatimeve.

d- Drejtoria e Të ardhurave Vendore Bashkia Korçë, të listojë në mënyrë elektronike abonentët familjarë dhe të merren masa për arkëtimin e taksave të familjarëve, taksës së tokës nga fermerët e Njësive Administrative. Në zbatim të udhëzimit plotësues të Ministrisë Financave nr. 2, datë 19.01.2018 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018”, pika 76, sipas të dhënave që disponon Gjendja Civile, të njoftohen tatimpaguesit familjarë dhe bizneset me Njoftim vlerësimi tatimor edhe në median lokale (të Bashkisë) për të paguar detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak, nëpërmjet dërgimit të njoftim vlerësimit me anë të zyrës postare, për të gjitha llojet dhe shumën e taksave të papaguara, si taksën e tokës, banesave dhe tarifafat etj.

Brenda datës 31.12.2018

D. MASA ADMINISTRATIVE:

D/I. Për Agjencinë e Prokurimit Publik.

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në akt-konstatimet nr. 9, datë 14.06.2018 (ish- Komuna Vithkuq), nr. 11, datë 14.06.2018 dhe nr. 12, datë 14.06.2018 (Ish- Komuna Bulgarec), vërejtjeve komentet e subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Mbështetur në nenet 13 dhe 72, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe bazuar në nenin 15 shkronja (c dhe ç) dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara**, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo rekomandimin autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), për **16** (gjashtëmbëdhjetë) punonjës dhe ish- punonjës, si më poshtë:

I- Në ish- Komunën Vithkuq për 6 persona:

1. G. II. me detyrë ish-Përgjegjës i Zyrës së Financës, në cilësinë e Kryetarit të KOV në 2 (dy) procedura.

2. P. SH. me detyrë ish- ish-Përgjegjës i Zyrës së Urbanistikës, dhe

3. A. H. me detyrë ish- arkëtar dhe specialist IT;

Në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për 2 (dy) procedura:

Për shkeljet e mëposhtme:

a. Tenderi me objekt: “Rikonstrukcion i qendrës së Komunës Vithkuq + rrugë lagje Saraq, Grekas, fshati Vithkuq”, me fond limit 2,833,165 lekë zhvilluar në vitin 2014, ku fitues është shpallur BOE “V.....A + K.....N” me vlerë kontrate 1,920,990 lekë.

Nga auditimi konstatohet se BOE “V.....A + K.....N” nuk plotëson kriteret e miratuara në DST për shpallje fitues, konkretisht: -Shoqëria “V.....A”, nuk disponon kategorinë e punimeve NS-14/A. Referuar kontratës së bashkëpunimit nr. 1169.1105, datë 09.06.2014 të lidhur midis shoqërisë “V.....A” dhe “K.....N”, përqindja e punimeve është ndarë 90% të punimeve shoqëria “V.....A” dhe 10% e punimeve “K.....N”, e aplikuar kjo në çdo zë të preventivit; - Shoqëria “K.....N” nuk ka paraqitur vërtetim për pagesën e taksave vendore.

Vendimi i marrë nga KVO për kualifikimin e BOE “V.....A + K.....N”, nuk është i saktë dhe KVO duhet të vijonte procedurën me operatorët e tjerë paraqitur në garë (procedurë e parregullt), veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1 “Objekti dhe qëllimi” pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 “Parimet e përzgjedhjes” germa (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46, 53 dhe 55 (Trajtuar në pikën III/C

nënpika 1.3 dhe faqet 117-133, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe akt-konstatimin nr. 9, datë 14.06.2018).

b. Tenderi me objekt: “Sistemim i rrugëve në fshatrat Lubonjë, Rehovë, Leshnjë”, zhvilluar në vitin 2013 me fond limit 2,239,471 lekë, ku fitues është shpallur BOE “A...K + R...G...K” me vlerë kontrate 2,097,290 lekë.

Nga auditimi konstatohet se BOE “A...K + R...G...K” nuk plotëson kriteret e miratuara në DST për shpallje fitues, konkretisht: *-Kontrata e bashkëpunimit nuk është në zbatim të LPP, pasi përqindja midis dy shoqërive e cila është 90% shoqëria “A...K” dhe 10% shoqëria “R...G...K”, nuk janë ndarë zërat e preventivit se cilat punime do ketë një shoqëri e cila tjetra; -Shoqëria “R...G...K”, nuk plotëson kriterin e veçantë në lidhje me licencën profesionale (pika 2.1/b e DST), pasi nuk disponon kategoritë e punimeve NP-5, NP-9 dhe NS-18; -Nga të dy shoqëritë nuk janë paraqitur dokumente që tregojnë se në licencat e shoqërive ka ing. Ndërtimi dhe ing. Topograf (licencat përkatëse).*

Vendimi i marrë nga KVO për kualifikimin e BOE “A...K + R...G...K”, nuk është i saktë dhe KVO midis dy operatorëve duhet të vlerësonte shoqërinë “V.....A”, pasi për të dy kriteret që KVO i ka quajtura të parregullta, nga shoqëria janë paraqitur, veprime të cilat kanë çuar në kualifikimin e OE me mangësi dhe ofertë ekonomike më të lartë dhe krijimin e demit ekonomik në vlerën **88,000 lekë**, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1 “Objekti dhe qëllimi” pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 “Parimet e përzgjedhjes” germa (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46, 53 dhe 55 (Trajtuar në pikën III/C nënpika 1.3 dhe faqet 117-133, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe akt-konstatimin nr. 9, datë 14.06.2018).

4. P. M. me detyrë ish- Veteriner, në cilësinë e Kryetarit të NJHDT në ish- komunën Vithkuq, në 1 (një) procedurë.

5. P. N. me detyrë ish- Inspektor i Pyjeve në komunën Vithkuq, dhe

6. S. S. me detyrë ish- Inspektor i Policisë së Komunës Vithkuq;

Në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Hartimit të Dokumenteve të tenderit, në 1 (një) procedurë.

Për shkeljet e mëposhtëm:

a. Në tenderin me objekt: “Sistemim asfaltim i rrugës Saraq-Ura J. Shorem në fshatin Vithkuq” me fond limit 1,353,360 lekë.

Nga NJP nuk është mbajtur procesverbal i hartimit të dokumenteve të tenderit veprime në kundërshtim me kreun V-Zhvillimi i procedurave, pika 2-Hartimi i dokumenteve të tenderit, germa (a) të VKM nr. 01, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publike”, i ndryshuar .

Në përcaktimin e kriterëve të DST, konstatohet se janë vendosur kriteret të cilat nuk përkojnë me zërat e punimeve sipas preventivit, faktor i cili ka ndikuar dhe në mospjesëmarrjen e operatorëve të tjerë në garë. Konkretisht është kërkuar kategori licencë NP-14B, e cila i përkon një volum punimesh nga 20-50 milionë lekë, ndërkohë që e gjithë vlera e investimit është 1.3 milionë lekë, veprime në kundërshtim me nenin 46, pika 1 dhe 3, e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 01, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V-Zhvillimi i procedurës, pika 2- Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit, duke shkaktuar pabarazi të operatorëve ekonomikë (Trajtuar në pikën III/C nënpika 1.3 dhe faqet 117-133, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe akt-konstatimin nr. 9, datë 14.06.2018).

II- Në ish- Komunën Voskop për 4 persona:

1. H. D. me detyrë ish- Përgjegjës i Zyrës së Financës, në cilësinë e Kryetarit të KVO, për 2 (dy) procedura.

2. R. GJ. me detyrë specialit pyjesh në NJA Voskop, në cilësinë e anëtarit të KVO në ish-Komunën Voskop, për 2 (dy) procedura:

Për shkeljet e mëposhtme

a. Tenderi me objekt: “*Rrethim i fushës te stadiumit fshati Polenë*”, zhvilluar në vitin 2013 me fond limit 1,666,250 lekë, ku fitues është shpallur OE “A....I me vlerë kontrate 1,653,910 lekë pa TVSH.

Referuar dokumentacioni të paraqitur në sistemin APP, si dhe arsyes së skualifikimit të shoqërisë “S.....K”, rezulton se kriteri për të cilën është skualifikuar nuk është kërkesë e DST, pasi në DST është kërkuar që OE të paraqes certifikatë *ISO (materialet te jene te standardizuara dhe te prodhuara me ISO 9001-2008)*, gjë të cilën shoqëria e ka paraqitur, por jo të destinuar për punime bordure dhe pllakave, këto janë element të cilat mund të shihen gjatë procesit të zbatimit të projektet që materialet të kërkohen me cilësi.

Pra skualifikimi i shoqërisë “S.....K” është i padrejtë dhe nisur nga kriteri kryesore “*Çmimi më i leverdishëm*”, KVO duhet të shpallte fitues këtë shoqëria për të bërë të mundësuar shmangien e efektit negativ të përdorimit të fondeve me dëm për vlerën **313,020 lekë** (1,653,910 – 1,340,890), si diferenca midis ofertave të OE, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1 “Objekti dhe qëllimi” pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 “Parimet e përzgjedhjes” germa (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46, 53 dhe 55 (*Trajtuar në pikën III/C nënpika 1.3 dhe faqet 139-146, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe akt-konstatimin nr. 11, datë 14.06.2018*).

b-Tenderi me objekt: “*Rikonstruksion shkolla e mesme Voskop*”, zhvilluar me datë 30,567,716 lekë pa TVSh, ku fitues është shpallur OE “XH.....O” me vlerë kontrate 29,900,300 lekë pa TVSh.

Nga auditimi konstatohet se OE fitues “XH.....O”, nuk plotëson të gjitha kërkesat e DST, veprime të cilat kanë çuar në shpalljen fitues padrejtësisht të këtij OE, konkretisht: -*Të ardhurat sipas pasqyrave financiare të viteve respektive, nuk përputhen me të ardhurat sipas vërtetimit të lëshuar nga administrata tatimore; -Nga shoqëria nuk është paraqitur vërtetimi për taksat lokale në vendet ku shoqëria ushtron aktivitet; -Nuk paraqet dokumentacion për ing. Mjedisi dhe ing. Topograf, pasi nuk ka asnjë dokument që tregon se kjo shoqëri ka te punësuar ing me këto lloje aktiviteti; -Vërtetimi i energjisë elektrike nuk është i saktë, pasi nuk është përfshirë muaj Qershor 2014, ndërkohë që tenderi është zhvilluar me 18 gusht 2014. Pra duhet që shoqëria të paguante detyrimet deri ne fund te qershorit 2014.*

Në këto kushte KVO ose duhej të anulonte procedurën pasi asnjë nga operatorët pjesëmarrës nuk plotëson kërkesat e DST, ose midis operatorëve pjesëmarrës në procedurë dhe me mangësi të vlerësonte kriterin kryesore që është “*Çmimi më i leverdishëm*”, për të bërë të mundur shmangien me efekt negativ të fondeve publike në vlerën **8,388,710 lekë**, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1 “Objekti dhe qëllimi” pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 “Parimet e përzgjedhjes” germa (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46, 53 dhe 55 (*Trajtuar në pikën III/C nënpika 1.3 dhe faqet 139-146, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe akt-konstatimin nr. 11, datë 14.06.2018*).

3. z. Ilirjan Konstatndini me detyrë Përgjegjës i Punëve të Publike Bashkia Korçë, në cilësinë e anëtarit të KVO në ish- Komunën Voskop, në 1 (një) procedurë:

Për shkeljet e mëposhtme:

a. Tenderi me objekt: “*Rrethim i fushës te stadiumit fshati Polenë*”, zhvilluar në vitin 2013 me fond limit 1,666,250 lekë, ku fitues është shpallur OE “A....I me vlerë kontrate 1,653,910 lekë pa TVSH.

Referuar dokumentacioni të paraqitur në sistemin APP, si dhe arsyes së skualifikimit të shoqërisë “S.....K”, rezulton se kriteri për të cilën është skualifikuar nuk është kërkesë e DST, pasi në DST është kërkuar që OE të paraqes certifikatë *ISO (materialet te jene te standardizuara dhe te*

prodhuara me ISO 9001-2008), gjë të cilën shoqëria e ka paraqitur, por jo të destinuar për punime bordure dhe pllakave, këto janë element të cilat mund të shihen gjatë procesit të zbatimit të projektet që materialet të kërkohen me cilësi.

Pra skualifikimi i shoqërisë “S.....K” është i padrejtë dhe nisur nga kriteri kryesorë “Çmimi më i leverdishëm”, KVO duhet të shpallte fitues këtë shoqëria për të bërë të mundësuar shmangien e efektit negativ të përdorimit të fondeve me **dëm për vlerën 313,020 lekë** (1,653,910 – 1,340,890), si diferenca midis ofertave të OE, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1 “Objekti dhe qëllimi” pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 “Parimet e përzgjedhjes” germa (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46, 53 dhe 55 (Trajtuar në pikën III/C nënpika 1.3 dhe faqet 139-146, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe akt-konstatimin nr. 11, datë 14.06.2018).

4. z. Sherif Seidolli me detyrë specialist në Drejtorinë e Bujqësie Bashkia Korçë, në cilësinë e anëtarit të KVO ish- Komuna Voskop, në 1 (një) procedurë:

Për shkeljet e mëposhtme:

a-Tenderi me objekt: “Rikonstruksion shkolla e mesme Voskop”, zhvilluar me datë 30,567,716 lekë pa TVSh, ku fitues është shpallur OE “XH.....O” me vlerë kontrate 29,900,300 lekë pa TVSh.

Nga auditimi konstatohet se OE fitues “XH.....O”, nuk plotëson të gjitha kërkesat e DST, veprime të cilat kanë çuar në shpalljen fitues padrejtësisht të këtij OE, konkretisht: -Të ardhurat sipas pasqyrave financiare të viteve respektive, nuk përputhen me të ardhurat sipas vërtetimit të lëshuar nga administrata tatimore; -Nga shoqëria nuk është paraqitur vërtetimi për taksat lokale në vendet ku shoqëria ushtron aktivitetet; -Nuk paraqet dokumentacion për ing. Mjedisi dhe ing. Topograf, pasi nuk ka asnjë dokument që tregon se kjo shoqëri ka të punësuar ing me këto lloje aktiviteti; -Vërtetimi i energjisë elektrike nuk është i saktë, pasi nuk është përfshirë muaj Qershor 2014, ndërkohë që tenderi është zhvilluar me 18 gusht 2014. Pra duhet që shoqëria të paguante detyrimet deri në fund të qershorit 2014.

Në këto kushte KVO ose duhej të anulonte procedurën pasi asnjë nga operatorët pjesëmarrës nuk plotëson kërkesat e DST, ose midis operatorëve pjesëmarrës në procedurë dhe me mangësi të vlerësonte kriterin kryesorë që është “Çmimi më i leverdishëm”, për të bërë të mundur shmangien me efekt negativ të fondeve publike në vlerën **8,388,710 lekë**, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1 “Objekti dhe qëllimi” pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 “Parimet e përzgjedhjes” germa (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46, 53 dhe 55 (Trajtuar në pikën III/C nënpika 1.3 dhe faqet 139-146, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe akt-konstatimin nr. 11, datë 14.06.2018).

III- Në ish- Komunën Bulgarec për 6 persona:

1. A. C. me detyrë specialist në Drejtorinë e Punëve Publike Bashkia Korçë, në cilësinë e Kryetarit të KVO në 2 (dy) procedura.

2. N. T. me detyrë ish- Drejtoresh Finance, dhe

3. M. A. me detyrë ish- specialist finance;

Në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në 2 (dy) procedura.

Për shkeljet e mëposhtme:

a. Në tenderin me objekt “Ndërtim ujësjellësi fshati Lumalas - Biranj”, me fond limit 12,031,554 lekë, zhvilluar në vitin 2013, ku fitues është shpallur BOE “A.....I & SH.....M”, me vlerë kontrate 11,507,146 lekë pa TVSh.

Nga auditimi konstatohet se BOE “A.....I & SH.....M” nuk plotëson të gjitha kriteret e miratuara në DST, konkretisht: **a-Shoqëria “A.....I” e cila sipas kontratës së bashkëpunimit nr. 1298/481, datë 25.05.2013 ka 55 %, nuk përmbush këto kritere:** -Nuk licencën profesionale nuk ka këto kategori punimesh NP-1B; NP-7C; NP-11B; NP-12B; NS-9A; NS-14A;NS-16A dhe NS-18A; -Në punimet e ngjashme nuk paraqet kontratën me sipërmarrësin për objektin “Ndërtim ujësjellësi

në fshatin Bare, Komuna Bulgarec” me vlerë 28,512,939 lekë, kusht për të cilën është skualifikuar dhe BOE “L.....I + C.....I” me ofertë më të leverdishme; -Nuk plotëson numrin e punonjësve për periudhën Janar 2012 – Shkurt 2013” prej 17 punonjësish; -Nuk paraqet stafin e nevojshëm inxhinierik siç kërkohet në DST, kriter për të cilin është skualifikuar BOE “V.....A + A.....A”; -Nuk paraqet pagesën e taksave vendore në vendet e ushtrimit të aktivitetit sipas QKR; -Nuk paraqet certifikatë ISO 14001:2004 dhe 18001:2007.

b-Shoqëria “SH.....M” e cila sipas kontratës së bashkëpunimit nr. 1298/481, datë 25.05.2013 ka 45 %, nuk përmbush këto kriteret: -Nuk paraqet vërtetim për xhiron e tre viteve të fundit nga administrata tatimore, siç kërkohet në pika 2.2/1 të DST; -Stafi inxhinierik i paraqitur, konstatohet se paga sipas kontratës së punës nuk përputhet me pagën në listpagesës e sigurimeve shoqërore; -Pasqyrat financiare të vitit 2012 nuk është certifikuar me ekspert siç kërkohet në DST;

-Të dy shoqëritë së bashku nuk plotësojnë kriterin për makineri, konkretisht “Makineri ngjitëse HDPE me elektrofuzion dhe ballorë copë 4 (katër), ndërkohë që nga shoqëritë janë paraqitur 3 (tre)copë.

Nga KVO janë mbajtur dy standarde, pasi për të njëjtin mangësi (Nuk plotëson stafin inxhinierik të kërkuar) është skualifikuar BOE “V.....A + A.....Y.II”, por me çmim, më të leverdishëm (7,094,371 lekë) se BOE shpallur fitues, duke mos vlerësuar kriterin kryesor “Çmimi më i leverdishëm”, për të bërë të mundur shmangien me efekt negativ të fondeve publike në vlerën **4,412,775 lekë** (11,507,146 – 7,094,371), veprime në kundërshtim me nenin 46, pika 1 dhe 3, e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 01, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V-Zhvillimi i procedurës, pika 2- Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit, duke shkaktuar pabarazi të operatorëve ekonomikë (Trajtuar në pikën III/C nënpika 1.3 dhe faqet 146-156, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe akt-konstatimin nr. 12, datë 14.06.2018).

b. Në tenderin me objekt “Ndërtim ujësjellësi fshati Bulgarec, Komuna Bulgarec”, me fond limit 25,019,235 lekë, zhvilluar në vitin 2013, ku fitues është shpallur BOE “C....I & L.....I” me vlerë kontrate 24,475,015 lekë.

Nga auditimi konstatohet se BOE “C....I & L.....I”, nuk plotëson të gjitha kërkesat e DST, konkretisht: **a-Shoqëria “L.....I”** e cila sipas kontratës së bashkëpunimit nr. 1298/481, datë 25.05.2013 ka 49 %, nuk përmbush këto kriteret: -Nuk licencën profesionale nuk ka këto kategori punimesh NP-1B; NP-7C; NP-11B; NP-12B; NS-8Q; NS-9A; NS-14A;NS-16A dhe NS-18A, siç kërkohet në DST, kjo pasi sipas kontratës së bashkëpunimit kjo shoqëri ka marrë përsipër 49% e punimeve në të gjithë zërat e preventivit; -Nuk paraqet pagesën e taksave vendore në vendet e ushtrimit të aktivitetit; -Nuk paraqet certifikatë ISO 14001:2004 dhe 18001:2007.

b-Të përbashkëta:-Stafi inxhinierik i cili është i mangët, nuk janë shoqëruar me licencat përkatëse nga MPPTT, siç kërkohet në pikën 2.2.3 të DST, kriter të për cilën janë skualifikuar dhe OE me oferta më të leverdishme; -Nuk paraqesin ing. Hidroteknik, ing. Ndërtimi dhe ing. Gjeodet siç kërkohet në pikën 2.2.3 të DST; -Marrëveshja e bashkëpunimit midis dy operatorëve nuk është sipas kërkesave ligjore, pasi nuk janë ndarë zërat e punimeve midis dy shoqërive se cilat punime do kryhej njëri operator dhe cili tjetri;

-Asnjë nga shoqëritë nuk paraqet certifikatë ISO 18001:2007.

Gjykojmë se nga KVO janë mbajtur dy standarde, pasi për të njëjtin mangësi (Nuk plotëson stafin inxhinierik të kërkuar) është skualifikuar BOE “V.....A + A.....Y.II”, por me çmim më të leverdishëm (16,577,698 lekë), duke mos vlerësuar kriterin kryesor që është “Çmimi më i leverdishëm”, për të bërë të mundur shmangien me efekt negativ të fondeve publike në vlerën **7,917,317 lekë** (24,475,015– 16,577,698), si diferenca midis ofertave të OE, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1 “Objekti dhe qëllimi” pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 “Parimet e përzgjedhjes” germa (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46, 53 dhe 55 (Trajtuar në pikën III/C nënpika 1.3 dhe faqet 139-146, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe akt-konstatimin nr. 12, datë 14.06.2018).

4. S. K. me detyrë ish Jurist, në cilësinë e Kryetarit të NJHDT në ish- komunën Bulgarec në 2 (tre) procedura.

5. G.J. XH. me detyrë ish- Drejtoresh Tatimesh, dhe

6. M. A. me detyrë ish-Përgjegjës Administrate;

Në cilësinë e anëtarëve të NJHDT në ish- komunën Bulgarec në 2 (tre) procedura.

Për shkeljet e mëposhtme:

a. Në tenderin me objekt “Ndërtim ujësjellësi fshati Lumalas - Biranj”, me fond limit 12,031,554 lekë, konstatohet se disa prej tyre nuk janë në përputhje me dispozitat ligjore të LPP dhe zërat e preventivit, konkretisht: *a-Janë kërkuar kategori licencë në nivel më të lartë se sa preventivi në përgjithësi, por dhe të zërave të veçantë. Kështu është kërkuar kategori NP-1B, NP-7C, NP-11B, NP-12B; b-Numri i lartë i punonjësve (30 punonjës) i paargumentuar, veprime në kundërshtim me nenin 46, pika 1 dhe 3, e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 01, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V-Zhvillimi i procedurës, pika 2- Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit, duke shkaktuar pabarazi të operatorëve ekonomikë (Trajtuar në pikën III/C nënpika 1.3 dhe faqet 139-146, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe akt-konstatimin nr. 12, datë 14.06.2018).*

b. Në tenderin me objekt “Ndërtim ujësjellësi fshati Bulgarec, Komuna Bulgarec”, me fond limit 25,019,235 lekë, konstatohet se disa kriteret nuk janë në përputhje me dispozitat ligjore të LPP dhe zërat e preventivit, konkretisht: *a-Janë kërkuar kategori licencë në nivel më të lartë se sa preventivi në përgjithësi, por dhe të zërave të veçantë. Kështu është kërkuar kategori NP-1B, NP-7C, NP-11B, NP-12B; b-Numri i lartë i punonjësve (30 punonjës) i paargumentuar; -Gjithashtu asnjë nga kriteret e vendosura nuk ka një analizë për të argumentuar arsyen e vendosjes së tyre, veprime në kundërshtim me nenin 46, pika 1 dhe 3, e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 01, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V-Zhvillimi i procedurës, pika 2- Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit, duke shkaktuar pabarazi të operatorëve ekonomikë. (Trajtuar në pikën III/C nënpika 1.3 dhe faqet 139-146, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe akt-konstatimin nr. 12, datë 14.06.2018).*

c. Në tenderin me objekt: “Ndërtim ujësjellësi fshati Barc” me fond limit 1,537,642 lekë.

Në përcaktimin e kriterëve të DST, konstatohet se janë vendosur kriteret të cilat nuk përkojnë me zërat e punimeve sipas preventivit, faktor i cili ka ndikuar dhe në mospjesëmarrjen e operatorëve të tjerë në garë. Konkretisht *Janë kërkuar kategori licencë në nivel më të lartë se sa preventivi në përgjithësi, por dhe të zërave të veçantë. Kështu është kërkuar kategori NP-1B, NP-7C, NP-11B, NP-12B; b-Numri i lartë i punonjësve (30 punonjës) i paargumentuar, ndërkohë që e gjithë vlera e investimit është 1.5 milionë lekë, veprime në kundërshtim me nenin 46, pika 1 dhe 3, e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 01, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V-Zhvillimi i procedurës, pika 2- Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit, duke shkaktuar pabarazi të operatorëve ekonomikë (Trajtuar në pikën III/C nënpika 1.3 dhe faqet 139-146, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe akt-konstatimin nr. 12, datë 14.06.2018).*

E. MASA DISIPLINORE

E/I. Mbështetur në nenin 58 “Llojet e masave disiplinore” dhe nenin 59 “Kompetencat dhe procedurat për masat disiplinore” të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 171, datë 26.3.2014 “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimimin nga shërbimi civil”, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Korçë:**

Të vlerësojë, në varësi të analizës së përgjegjësive, shkallën e përgjegjësisë për mangësitë dhe shkeljet për secilin punonjës, të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe të filloi procedurat për dhënien e masave disiplinore:

-Nga “Vërejtje ose Ulje në detyrë” deri në “Largim nga puna”, për 11 punonjës të Bashkisë Korçë:

1. M. S., me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Prokurimeve, në cilësinë e anëtares së Njesisë së Hartimit të Dokumenteve të tenderit (NJHDT), për shkelje në 5 (pesë) procedura prokurimi, si më poshtë:

- Rikualifikimi urban i zonës përreth “Qytezës të fëmijëve” Korçë
- Rikonstrukcion i Teatrit A.Z.Çajupi, faza e dytë
- Rehabilitim i zonave informale (lagj. 18,17 fundi i parkut Rinia)
- Rehabilitim i rrjetit të kanaleve ujitës, bashkia Korçë
- Rehabilitimi urban, ndriçim, gjelbërim, ne zona te ndryshme ne qytet.

2. M. B. me detyrë specialiste në Drejtorinë e Procedurave të Prokurimit, në cilësinë e anëtares së Njesisë së Hartimit të Dokumenteve të tenderit (NJHDT), për shkelje në 5 (pesë) procedura, si më poshtë:

- Rikualifikimi urban i zonës përreth “Qytezës të fëmijëve” Korçë
- Rikonstrukcion i Teatrit A.Z.Çajupi, faza e dytë
- Rehabilitim i zonave informale (lgj 18,17 fundi i parkut Rinia)
- Rehabilitim i rrjetit të kanaleve ujitës, bashkia Korçë
- Rehabilitimi urban, ndriçim, gjelbërim, ne zona te ndryshme ne qytet.

3. B. M. me detyrë specialist në Drejtorinë e Planifikim Zhvillim Territorit, në cilësinë e anëtares së Njesisë së Hartimit të Dokumenteve të tenderit (NJHDT), për shkelje në 5 (pesë) procedura, si më poshtë:

- Rikualifikimi urban i zonës përreth “Qytezës të fëmijëve” Korçë
- Rikonstrukcion i Teatrit A.Z. Çajupi, faza e dytë
- Rehabilitim i zonave informale (Lagjja 18,17 fundi i parkut Rinia)
- Rehabilitim i rrjetit të kanaleve ujitës, bashkia Korçë
- Rehabilitimi urban, ndriçim, gjelbërim, ne zona te ndryshme ne qytet.

Për shkeljet e konstatuara në procedurat e mësipërme të zhvilluar në Bashkinë Korçë për periudhën e viteve 2016 – 2017, ku konstatohet se nga Njësia e Hartimit të Dokumenteve të Tenderit (NJHDT), janë vendosur kritere jo në lidhje me zërat e preventivave të punimeve dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokuruar, duke mos argumentuar domosdoshmërinë e tyre, në papajtueshmëri me nenin 41- “Dokumentet e tenderit”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe Kreut V- “Zhvillimi i procedurës” pika 2- “Hartimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 01, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të PP”, i ndryshuar (Trajtuar në pikën III/C dhe faqet 51-106, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4. O. P. me detyrë Specialist në Drejtorinë e Buxhetit, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për shkelje në 2 (dy) procedura, si më poshtë:

- Rikualifikimi urban i zonës përreth “Qytezës të fëmijëve” Korçë.

- Rikonstruksion i Teatrit A.Z. Çajupi, faza e dytë.

5. H. N., me detyrë Specialist në Drejtorinë e Planifikim Zhvillim Territorit, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për shkelje në 3 (tre) procedura, si më poshtë:

- Rikualifikimi urban i zonës përreth “Qytezës të fëmijëve” Korçë
- Rikonstruksion i Teatrit A.Z. Çajupi, faza e dytë
- Rikonstruksion i Teatrit A.Z. Çajupi, faza e dytë.

6. E. S. me detyrë Zv/Kryetar Bashkie, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

7. A. D. me detyrë specialist në Drejtorinë e Planifikim e Zhvillim Territorit, dhe

8. M. A. me detyrë ish- Specialiste në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore.

Në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për shkeljen e konstatuar në 1(një) procedurë:

- Rikonstruksion i Teatrit A.Z. Çajupi, faza e dytë.

9. B. TH. me detyrë Zv/ Kryetare Bashkisë Korçë, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;

10. I. M me detyrë specialiste në Drejtorinë Juridike Bashkia Korçë, dhe

11. L. GJ. me detyrë Drejtor i Menaxhimit të Kontratave të Infrastrukturës.

Në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të ofertave, për shkeljen e konstatuar në 1 (një) procedurë:

- Rikualifikimi urban i zonës përreth “Qytezës të fëmijëve” Korçë.

Për shkeljet e konstatuara në procedurat e mësipërme të zhvilluar në Bashkinë Korçë për periudhën e viteve 2016 – 2017, ku Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) ka shpallur fitues fitues OE/BOE me mangësi në plotësimin e kriterëve të DST të miratuara nga Autoriteti Kontraktor (AK) dhe Njësia e Hartimit të Dokumenteve të Tenderit (NJHDT), duke mos anuluar procedurën, veprime në kundërshtim me neni 1- “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, germa (c, ç, d, dh), neni 2-“Parimet e përzgjedhjes”, neni 24- “Anulimi i një procedure prokurimi”, neni 53- “Shqyrtimi i ofertave”, neni 55- “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, si dhe neni 66, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar (Trajtuar në pikën III/C dhe faqet 51-106, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

E/2. Për **4 punonjësit** të cilët aktualisht rezultojnë në marrëdhënie pune me Bashkinë Korçë, të cilët edhe pse janë identifikuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për disa të meta e mangësi që nuk i kapërcejnë kufijtë e shkeljes administrative, për arsye se asnjëra prej tyre gjatë përmbushjes së detyrave, nuk ka ndikuar negativisht apo ka sjellë pasoja të konsiderueshme në mirëfunksionimin e institucionit, konsiderojmë që për to të mos propozohet masë. Po ashtu i njëjti qëndrim vlen edhe për punonjësit të cilët janë trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit, janë në marrëdhënie pune me institucionin por që ndaj tyre janë marrë masa nga vet titullari i bashkisë apo janë transferuar në një detyrë tjetër, respektivisht:

1. A. D. me detyrë Drejtor i Përgjithshme.

2. J. M. me detyrë Përgjegjës në Sektorin e Pyjeve.

3. A. T. me detyrë Drejtoreshë e Auditit të Brendshëm.

4. V. Z. me detyrë Drejtor Finance.

F. INDICJE PENALE:

Në zbatim të nenit 15 germa (gj), të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe nenit 248, të ligjit nr. 7905, datë 21.3.1995 “Kodit Procedurës Penale”, i ndryshuar, *sugjerojmë trajtimin e detajuar tekniko juridik nga ana e Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës të shkeljeve të*

konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe aktet e tjera bashkëlidhur lidhur, për vlerësim dhe veprime të mëtejshme procedurale, për tenderat e zhvilluar në ish- komunat Voskop dhe Bulgarec, si vijon:

1- Në tenderin me objekt: “Rikonstruksion shkolla e mesme Voskop” të zhvilluar në **ish-Komunën Voskop** (viti 2014), me fond limit 30,567,716 lekë, ku fitues është shpallur OE “XH.....O”, me vlerë 29,900,300 lekë (*Trajtuar në pikën III/C nënpika 1.3, faqet 13-146 të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe akt-konstatimin nr. 11, datë 14.06.2018*).

2- Në tenderin me objekt “Ndërtim ujësjellësi fshati Lumalas - Biranj”, të zhvilluar në **ish-Komunën Bulgarec** (viti 2013), me fond limit 12,031,554 lekë, ku fitues është shpallur bashkimi operatorëve “A.....I & SH.....M”, me vlerë 11,507,146 lekë (*Trajtuar në pikën III/C nënpika 1.3, faqet 13-146 të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe akt-konstatimin nr. 12, datë 14.06.2018*).

3- Në tenderin me objekt “Ndërtim ujësjellësi fshati Bulgarec, Komuna Bulgarec”, të zhvilluar në **ish-Komunën Bulgarec** (viti 2013), me fond limit 25,019,235 lekë, ku fitues është shpallur bashkimi operatorëve “C....I & L.....P” me vlerë 24,475,015 lekë (*Trajtuar në pikën III/C nënpika 1.3, faqet 13-146 të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe akt-konstatimin nr. 12, datë 14.06.2018*).

G. PËR NJOFTIMIN E DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër (Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Institucionit), pasi të zbatohet procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e masave disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

1. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar.

2. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 1 Komisionari për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar.

H. Kontratat e punimeve të lidhura midis Bashkisë Korçë dhe operatorëve ekonomik të shpallur fitues në procedurat e prokurimit, zbatimi i të cilave është në proces (*si pasojë e zgjatjes së afateve të punimeve*), do të jenë objekt në auditimin e radhës që do kryhet në Bashkinë Korçë.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore dhe Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R